57-vjeçari kërcënon me jetë nipin për pronën



09.07 30/11/2022

Një 57-vjeçar përfundoi në pranga në Kavajë pasi kërcënoi me armë nipin e tij. Shkak për ngjarjen për ngjarjen sipas policisë u bë konflikti për pronën.

" Shërbimet e Komisariatit të Policisë Kavajë, pas marrjes së kallëzimit nga shtetasi A. S., 30 vjeç, se xhaxhai i tij e kishte kanosur se do ta vriste, për motive pronësie, menjëherë kanë organizuar punën dhe kanë finalizuar operacionin policor të koduar "Property", në kuadër të të cilit u bë kapja dhe arrestimi i shtetasit: I. S., 57 vjeç, banues në Kavajë.

57-vjeçari ka kanosur për jetën nipin e tij, shtetasin A. S., 30 vjeç, për motive pronësie. Gjatë kontrollit të banesës së 57-vjeçarit, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, një armë zjarri automatik, dy krehra dhe municion luftarak", thuhet në njoftimin e policisë për ngjarjen.***/tvklan.al**

TË NGJASHME

Atentati ndaj biznesmenit Dashamir Gjoka, ekstradohet nga Spanja edhe Morel Kërtalli

12:23 18/12/2022

Policia: 19 operacione të finalizuara në një javë

12:12 18/12/2022

Arrestohet punonjësi i Postës në Tropojë, shpallet në kërkim një tjetër

10:44 18/12/2022

Vinte baste sportive, vihet në pranga 19-vjeçari

09:31 18/12/2022

Shqiptari në Angli qëllohet me pistoletë elektrike nga policia, ndërron jetë

20:45 17/12/2022

33-vjeçari spërkat me benzinë Policinë e Elbasanit dhe i vendos flakën murit rrethues

18:36 17/12/2022

Makina përplas 59-vjeçarin me biçikletë në Shkodër

18:14 17/12/2022

Makina përplas 60-vjeçaren në kryeqytet

18:05 17/12/2022

Shpërthen bombola e gazit, plagosen 3 anëtarët e familjes

16:22 17/12/2022

© 2022 TV Klan. All Rights Reserved.